



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

**GJIMNAZI
SHKENCA NATYRORE**



Prishtinë, 23 qershor 2012

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

MATEMATIKË

1. Sa është vlera e $\log(2x - 4) = 3$?

- A. 488
- B. 4998
- C. 502
- D. 5002

2. Në qoftë se vlenë $\begin{vmatrix} x & y \\ -4 & 2 \end{vmatrix} - \begin{vmatrix} y & -1 \\ -x & -2 \end{vmatrix} = 0$, sa është vlera e $\frac{x}{y}$?

- A. -2
- B. 2
- C. -7
- D. 8

3. Është dhënë funksioni $f(x) = 2x - \ln(\cos x)$. Sa do të jetë $f'(x)$?

- A. $f'(x) = 2 - \ln(\sin x)$
- B. $f'(x) = 2 + \cot x$
- C. $f'(x) = 2 - \ln(\cos x)$
- D. $f'(x) = 2 + \tan x$

4. Nëse $a - b = 7$ dhe $a^2 - b^2 = 21$ sa është vlera e $2b$?

- A. -2
- B. -4
- C. 2
- D. 4

5. Tabela vijuese tregon vlerat e një funksioni f dhe derivatit të tij f' .

x	$f(x)$	$f'(x)$
0	2	5
1	4	-3
2	-2	3
3	4	2

Nëse funksioni h është dhënë me $h(x) = (f(x))^2$, sa është $h'(1)$?

- A. -24
- B. 20
- C. 16
- D. -12

6. Janë dhënë barazimet $\frac{9^x}{3^{x+y}} = 27$ dhe $\frac{16^x}{2^{x-y}} = 2$. Sa është vlera e $x \cdot y^2$?
- A. 2
B. 4
C. 6
D. 8
7. Nëse $\cos x + \frac{1}{\cos x} = \frac{1}{3}$ sa është vlera e shprehjes $\cos^2 x + \frac{1}{\cos^2 x}$?
- A. $\frac{1}{9}$
B. $\frac{17}{9}$
C. $-\frac{17}{9}$
D. $-\frac{1}{9}$
8. Cili është forma kanonike e ekuacionit të hiperbolës nëse $a = \sqrt{8}$ dhe $b = \sqrt{14}$?
- A. $49x^2 - 64y^2 = 56$
B. $7x^2 - 8y^2 = 1$
C. $14x^2 - 16y^2 = 1$
D. $7x^2 - 8y^2 = 56$
9. Në trekëndëshin këndngusht ABC , janë dhënë $a = 2$, $b = 2\sqrt{2}$ dhe $\beta = 45^\circ$. Zbato teoremen e sinusit dhe trego se cila është vlera e këndit α ?
- A. $\alpha = 30^\circ$
B. $\alpha = 45^\circ$
C. $\alpha = 60^\circ$
D. $\alpha = 75^\circ$
10. Është dhënë funksionit $f(x) = x^3 - 3x - 2$. Cili nga pohimet është i saktë ?
- A. Funksioni është tek.
B. Funksioni ka asimptotë vertikale.
C. Funksioni ka shkëputje në pikën $x = 1$.
D. Funksioni është rritës në intervalin $x \in (-\infty, -1) \cup (1, +\infty)$

FIZIKË

11. Në cilin nga këto raste, njeriu ushtron shtypje më të vogël në bazë ?

- A. Kur është i ulur
- B. Kur është i shtrirë
- C. Duke qëndruar në dy këmbë
- D. Duke qëndruar në një këmbë

12. Cila nga shprehjet e mëposhtme është e saktë për njësinë matëse të induksionit magnetik Teslla (T) ?


- A. $T = \frac{Wb}{m^2}$
- B. $T = Wb \cdot m^2$
- C. $T = \frac{Wb}{m}$
- D. $T = Wb \cdot m$

13. Nxehtësia në ngrohësin e një makine termike është (Q_1) kurse në ftohës është (Q_2). Në cilin rast rendimenti i makinës është maksimal ($\eta = 1$) ?

- A. $Q_1 = 0$
- B. $Q_1 = Q_2$
- C. $Q_2 = 0$
- D. $Q_1 > Q_2$

14. Në figurë është paraqitur rasti kur rrezja e dritës bie në sipërfaqen kufitare që ndan vakumin me qelqin. Cila nga drejtëzat paraqet rrezen e thyer ?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4




15. Si quhet procesi sipas të cilit lëngu kalon në gaz ?

- A. Shkrirje
- B. Avullim
- C. Kondensim
- D. Sublimin

16. Në diagram është dhënë varësia e elongacionit (zhvendosjes) të lëkundjes ndaj kohës. Sa është elongacioni i kësaj lëkundje për kohën $t=3s$?

- A. 0 cm
- B. 3 cm
- C. 7.5 cm
- D. 2.5 cm



17. Një top hendbolli lëvizë duke u rrotulluar nëpër palestrën sportive. Me cilën nga këto shprehje llogaritet energjia e përgjithshme kinetike e topit në lëvizje ?


A. $E_k = \frac{mv^2}{2}$

B. $E_k = \frac{I\omega^2}{2}$

C. $E_k = \frac{I\omega^2}{2} + \frac{mv^2}{2}$

D. $E_k = \frac{I\omega}{2} + \frac{mv^2}{2}$

18. Cila grimcë mungon në reaksionin e poshtëshënuar ?



A. ${}_1H^1$


B. ${}_0n^1$

C. ${}_1H^2$

D. ${}_1e^0$

19. Në figurë është paraqitur sfera e ngarkuar me elektricitet pozitiv dhe shufra elektroneutrale. Cili nga pohimet vijuese përshkruan saktë zhvendosjen e ngarkesave elektrike gjatë kontaktit të shufrës me sferën ?

- A. Ngarkesat negative nga sfera kalojnë tek shufra
- B. Ngarkesat pozitive nga sfera kalojnë tek shufra
- C. Ngarkesat pozitive nga shufra kalojnë tek sfera
- D. Ngarkesat negative nga shufra kalojnë tek sfera



20. Gjatësia valore e fotonit të parë me energji E_1 është λ_1 . Fotoni i dytë ka energji pesë herë më të vogël se i pari $E_2 = \frac{E_1}{5}$. Sa është gjatësia valore e fotonit të dytë ?


A. $\lambda_2 = 5\lambda_1$

B. $\lambda_2 = \lambda_1$

C. $\lambda_2 = \frac{\lambda_1}{5}$

D. $\lambda_2 = \frac{5}{\lambda_1}$

21. Në figurë është paraqitur makina për transportin e qumështit. Duke u bazuar në formën e nivelit të qumështit cili nga versionet e paraqitura në figurë paraqet gjendjen e lëvizjes së përsheptuar të makinës ?




- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4

22. Çfarë ndodhë, kur elektroni në një atom kalon nga niveli më i ulët energjetik E_1 në atë më të lartë E_2 ?

- A. Absorbohet fotoni me energji E_2-E_1
- B. Emitohet fotoni me energji E_1-E_2
- C. Emitohet fotoni me energji E_2-E_1
- D. Absorbohet fotoni me energji E_1-E_2


23. Trupi zhvendoset përgjatë boshtit x , ku varësia kohore e pozitës është sikurse në figurë. Sa është zhvendosja x pas kohës $t=4$ s ?

- A. 10 m
- B. 20 m
- C. 100 m
- D. 200 m




24. Në figurë është paraqitur një elektromagnet i thjeshtë i ndërtuar nga një gozhdë e cila është e mbështjellur me një përçues të izoluar skajet e së cilit janë të lidhura për bateri. Në cilën nga pozitat e shënuara ndodhet poli i veriut i fushës magnetike?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4




25. Në sferën qiellore janë shënuar pika dhe vijat të ndryshme. (shih.fig). Cila vijë paraqet horizontin dhe cila pikë paraqet zenitin ?

- A. Vija f dhe pika A
- B. Vija f dhe pika C
- C. Vija b dhe pika E
- D. Vija b dhe pika D




26. Në figurë është paraqitur varësia e shtypjes hidrostatike p e katër lëngjeve të ndryshme në funksion të thellësisë h . Cili nga këto lëngje e ka densitetin më të madh ?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4



27. Në figurë është dhënë qarku elektrik i cili përbehet prej një burimi (bateria), dy shpenzueseve (llamba dhe freskuesja) si dhe 4 ndërprerësve. Përmes cilit ndërprerës mund të çkyqim vetëm freskuesen e ajrit ?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4




28. Valët e emituara nga një telefon mobil janë ndërveprim i dy fushave fizike. Cilat janë këto dy fusha ?

- A. Fusha gravitacionale dhe elektrike
- B. Fusha elektrike dhe magnetike
- C. Fusha magnetike dhe bërthamore
- D. Fusha bërthamore dhe gravitacionale

29. Në figurë është paraqitur një vajzë e cila e rrotullon një trup përgjatë trajektorës rrethore. Cila është vlera e forcës centripetale që vepron në trup ?

- A. $F = 100N$ *
- B. $F = 20N$
- C. $F = 200N$
- D. $F = 40N$




30. Kur sfera prej alumini ftohet, vëllimi i saj do të zvogëlohet. Pse ndodh ky zvogëlim ?

- A. Sepse rritet numri i atomeve
- B. Sepse zvogëlohet madhësia e atomeve
- C. Sepse rritet distanca ndërmjet atomeve
- D. Sepse zvogëlohet distanca ndërmjet atomeve

KIMI





- 31.** Me cilën metodë mund të ndahet rëra nga uji ?
- A. Me filtrim
 - B. Me sublimim
 - C. Me ndarje me magnet
 - D. Me distilim fraksional
- 32.** Sa është pH e një tretësire bazike ?
- A. pH=1
 - B. pH=4
 - C. pH=7
 - D. pH=11
- 33.** Cilat grimca subatomike gjenden në mbështjellësin elektronik të atomit ?
- A. Vetëm neutronet
 - B. Vetëm elektronet
 - C. Protonet dhe neutronet
 - D. Protonet dhe elektronet
- 34.** Si quhet reaksioni i bashkëveprimit të estereve me ujë ?
- A. Hidrolizë
 - B. Elektrolizë
 - C. Esterifikim
 - D. Polimerizim
- 35.** Cili nga komponimet vijuese, kur reagon me ujë liron hidrogjenin e gaztë ?
- A. CH₄
 - B. CaH₂
 - C. NH₃
 - D. H₂S

- 36.** Në këtë reaksion kimik, njëri nga produktet e fituara është:



- A. metil fenil ketoni
- B. metil benzeni
- C. etil benzeni
- D. klor benzeni

37. Cilat nga çiftet vijuese janë izomerë në mes vete ?



38. Çfarë mjedisi tregon tretësira ujore e klorurit të amonit (NH_4Cl)?

- A. Bazik
- B. Neutral
- C. Acidik
- D. Amfotern





39. Cili është dallimi në mes të jonit klorur (Cl^-) dhe atomit të klorit (Cl) ?

- A. Joni klorur (Cl^-) ka një elektron më shumë sesa atomi i klorit (Cl)
- B. Joni klorur (Cl^-) ka një proton më pak sesa atomi i klorit (Cl)
- C. Joni klorur (Cl^-) ka një proton më shumë sesa atomi i klorit (Cl)
- D. Joni klorur (Cl^-) ka një elektron më pak sesa atomi i klorit (Cl)

40. Cili reaksion ndodh gjatë elektrolizës së klorurit të kalciumit CaCl_2 të shkrirë ?

- A. $\text{Ca} \rightarrow \text{Ca}^{+2} + 2\text{e}^-$
- B. $\text{Ca} + 2\text{e}^- \rightarrow \text{Ca}^{+2}$
- C. $\text{Ca}^{+2} \rightarrow \text{Ca} + 2\text{e}^-$
- D. $\text{Ca}^{+2} + 2\text{e}^- \rightarrow \text{Ca}$

41. Cili komponim përfitohet me oksidimin e propanolit-2 ?



42. Cilat sheqerna bëjnë pjesë në grupin e polisakarideve ?

- A. Fruktoza dhe glukoza
- B. Amidoni dhe celuloza
- C. Saharoza dhe laktoza
- D. Riboza dhe ribuloza

43. Në një epruvetë janë përzier kristalet e klorurit të natriumit (NaCl) dhe të klorurit të amonit (NH₄Cl), nëse epruveta nxehtet në flakëdhënës do të vërejmë se:

- A. NaCl mbetet në pjesën e nxehtë ndërsa NH₄Cl sublimon në pjesën e ftohtë të epruvetës
- B. të dy kripërat shkrihen
- C. të dy kripërat sublimojnë
- D. NH₄Cl mbetet në pjesën e nxehtë ndërsa NaCl sublimon në pjesën e ftohtë të epruvetës





44. Një kimist i analizon dy substanca kimike A dhe B. Rezultatet e analizës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Lloji i analizës	Substanca A	Substanca B
Fortësia	E fortë	E butë
Ngjyra	E tejdukshme	E zezë
Dendësia	3.51	2.26
Përçueshmëria elektrike	Jopërçues	Përçues i mirë

Nga rezultatet e këtyre testeve përfundojmë se:

- A. substanca A është grafiti dhe substanca B diamanti
- B. substanca A është bakri dhe substanca B natriumi
- C. substanca A është diamanti dhe substanca B grafiti
- D. substanca A është natriumi dhe substanca B bakri

45. Cili nga hidrokarburet vijuese ka pikën e vlimit më të ulët ?




46. Kromi në dikromat amoni, (NH₄)₂Cr₂O₇ paraqitet me numër oksidues:


- A. +3
- B. +5
- C. +6
- D. +7

47. Cilat diagrame të mëposhtme paraqesin përzierje?

- A. I dhe III
- B. Vetëm I
- C. Vetëm II
- D. I dhe II







48. Sipas sistemit IUPAC, emri i hidrokarburit vijues është:




- A. dietil-4,6-hepteni-3
- B. dietil-2,4-hepteni-4
- C. etil-5-metil-3-okteni-5
- D. etil-4-metil-6-okteni-3

49. Cila nga aminat vijuese ka veti më të dobëta bazike ?



50. Nga formula strukturale e shënuar, konstatojmë se ky komponim është:

- A. dipeptid alaninë-glicinë
- B. dipeptid valinë-glicinë
- C. dipeptid glicinë-alaninë
- D. dipeptid alaninë-valinë



51. Sipas Ligjit të parë të termodinamikës:

- A. energjia e brendshme e një sistemi të izoluar është relative
- B. energjia e brendshme e një sistemi të izoluar është konstante
- C. energjia e brendshme e një sistemi të izoluar është maksimale
- D. energjia e brendshme e një sistemi të izoluar është minimale

52. Cili prej këtyre metaleve bën pjesë në metalurgjinë me ngjyra ?

- A. Hekuri
- B. Giza
- C. Çeliku
- D. Plumbi

53. Është dhënë reaksioni: $N_2(g) + 3H_2(g) \rightleftharpoons 2NH_3(g)$. Cila është konstanta e drejtpeshimit kimik të këtij reaksioni ?


- A. $K = \frac{[NH_3]^2}{[N_2] \cdot [H_2]^3}$
- B. $K = \frac{[NH_3]^2}{[N_2] \cdot [3H_2]}$
- C. $K = \frac{[2NH_3]}{[N_2] \cdot [3H_2]}$
- D. $K = \frac{[2NH_3]^2}{[N_2] \cdot [3H_2]^3}$

54. Cili është konfiguracioni elektronik i jonit ${}_{20}Ca^{2+}$?

- A. $1 s^2 2 s^2 2 p^6 3 s^2 3 p^6$
- B. $1 s^2 2 s^2 2 p^6 3 s^2 3 p^6 4 s^2$
- C. $1 s^2 2 s^2 2 p^6 3 s^2 4 p^6$
- D. $1 s^2 2 s^2 2 p^6 3 s^2 4 p^6 4 s^2$

55. Çka ndodh nëse bëhet elektroliza e tretësirës ujore të NaCl ?

- A. Hidrogjeni lirohet në anodë
- B. Klori lirohet në katodë
- C. Natriumi ndahet në anodë
- D. Natriumi tretet në ujë



BIOLOGJI

- 56.** Cili nga këto gjene është heterozigot ?
- A. bbcc
 - B. BBCC
 - C. BbCc
 - D. AABB
- 57.** Sa palë çifte nervore dalin prej trurit të zvarranikëve ?
- A. 10 palë
 - B. 12 palë
 - C. 20 palë
 - D. 24 pale
- 58.** Cila nga këto bimë përmban më së shumti fitoncide ?
- A. Molla
 - B. Dardha
 - C. Kumbulla
 - D. Dëllinja
- 59.** Cili organ i tretjes te njeriu e pengon kalimin e ujit në rrugët e frymëmarrjes ?
- A. Faringu
 - B. Laringu
 - C. Epiglotisi
 - D. Duodenumi
- 60.** Në cilën pjesë të qelizës kryhet oksidimi i materieve organike përmes ciklit pentozik ?
- A. Ribozome
 - B. Citoplazmë
 - C. Kloroplaste
 - D. Mitokondrie
- 61.** Nëse te prindërit gjenotipi për përcaktimin e grupeve të gjakut është AA x BO, çfarë do të jetë gjenotipi te pasardhësit ?
- A. AO, AB
 - B. AO, BO
 - C. AB, OO
 - D. OA, OB
- 62.** Çka ndodh në organizmin e njeriut nëse nuk funksionojnë veshkat ?
- A. Ndërprerja e qarkullimit të gjakut dhe limfës
 - B. Ndërprerja e prodhimit të insulinës dhe glukagonit
 - C. Ndërprerja e prodhimit të hormoneve tiroksinë dhe trijodtironinë
 - D. Ndërprerja e ekskretimit të produkteve përfundimtare të metabolizmit

- 63.** Cilat nga këto organele qelizore e mbrojnë organizmin nga mikroorganizmat ?
- Mitokondritë
 - Lizozomet
 - Aparati i Golxhit
 - Ribozomet
- 64.** Cila prej bimëve të mëposhtme është indikator biologjik që përcakton shkallën e ndotjes së mjedisit ?
- Likeni
 - Pisha
 - Gështenja
 - Fieri
- 65.** Cila metodë aplikohet për pastrimin e mjedisit të ndotur nga bakteriet duke i përdorur bazat ?
- Sterilizimi
 - Deratizimi
 - Pasterizimi
 - Dezinfektimi
- 66.** Cila është faza e fundit e ciklit të zhvillimit të bakteriofagut ?
- Depërtimi i acidit nukleik të virusit në qelizën bakteriale
 - Formimi i kapsidave dhe acideve nukleike të viruseve
 - Kompletimi dhe lirimi i bakteriofagëve të rinj
 - Ngjitja e virusit për sipërfaqen e qelizës bakteriale
- 67.** Gjatë procesit të frymëmarrjes shkëmbimi i dioksidit të karbonit (CO₂) në mes gjakut dhe ajrit bëhet përmes:
- trakeve
 - alveoleve
 - faringut
 - laringut
- 68.** Cilat etapa të njëpasnjëshme kryhen në interfazë gjatë një cikli të ndarjes qelizore ?
- G₁-S-G₂
 - G₁-G₂-S
 - S-G₂-G₁
 - G₁-G₂-S
- 69.** Qarkullimi i vogël i gjakut te njeriu:
- fillon nga barkushja e majtë dhe përfundon në veshëzën e djathtë
 - fillon nga veshëza e djathtë dhe përfundon në barkushen e majtë
 - fillon nga barkushja e djathtë dhe përfundon në veshëzën e majtë
 - fillon nga veshëza e majtë dhe përfundon në barkushen e djathtë

70. Sa aminoacide në sintezën e proteinave kodohen nga vargu i mëposhtëm i ARN(i) ?
UGGUUUGGCUCA

- A. Tri aminoacide
- B. Katër aminoacide
- C. Pesë aminoacide
- D. Tetë aminoacide

71. Në cilën pjesë të lëkurës gjenden receptorët për prekje ?

- A. Dermë
- B. Epidermë
- C. Ind dhjamor
- D. Ind nënlëkuror

72. Si quhet vendi ku bashkohet qeliza nervore me qelizën e muskulit të lëmuar ?

- A. Akson
- B. Neurit
- C. Dentrit
- D. Sinapsë

73. Nukleotidet janë njësi ndërtimore që marrin pjesë në ndërtimin e:


- A. yndyrave
- B. acideve nukleike
- C. karbohidrateve
- D. proteinave

74. Si quhet tipi i organit ekskretues te shpendët ?

- A. Pronefros
- B. Protonefridie
- C. Metanefros
- D. Metanefridie

75. Cili grup i algave është i paraqitur në figurë ?

- A. Algat blu të gjelbëra
- B. Algat e gjelbëra
- C. Algat e murrme
- D. Algat silikate




76. Antikodoni është pjesë e :

- A. ADN
- B. ARN(i)
- C. ARN(r)
- D. ARN(t)

77. Cila fazë e ndarjes së qelizës me mejozë është paraqitur në figurë?

- A. Anafaza e I
- B. Metafaza e I
- C. Profaza
- D. Telofaza



78. Si quhen bimët me lule të vërtetë me fryte ?

- A. Alga
- B. Farëveshura
- C. Fierna
- D. Farëzhveshura

79. Si quhet forma e bashkëjetesës së dy organizmave që kanë dobi të ndërsjellë por jo të obligueshme ?

- A. Protokooperim
- B. Komensalizëm
- C. Mutualizëm
- D. Neutralizëm

80. Në figurë është paraqitur piramida ushqimore dhe biomasa e gjallesave në një ekosistem. Në cilin nivel ushqyes gjenden mishngrënësit e rendit të parë ?

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

